

VENDIM
Nr. 519, datë 21.12.2021

PËR LICENCIMIN PËR HERË TË PARË TË SHOQËRISË
UJËSJELLËS-KANALIZIME MEMALIAJ SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM-ja nr. 958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

Në mbledhjen e datës 21.12.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit ‘Për licencimin për herë të parë të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Memaliaj sh.a.’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Memaliaj (UK Memaliaj), me shkresën nr. prot. 130, datë 22.10.2021, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU), kërkesën për licencim për herë të parë.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR-ja) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për herë të parë të UK Memaliaj, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM-ja nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton se:

a) Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Memaliaj sh.a. (NUIS M09831502C) është themeluar me statut nga Bashkia Memaliaj më 23.12.2020 dhe është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), më datë 31.12.2020, me aksionarë të vetëm Bashkinë Memaliaj;

b) Shoqëria UK Memaliaj aplikon për licencim për herë të parë, si shoqëri e re, për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, e shkëputur nga UK Tepelenë me të cilën ka qenë e bashkuar deri në momentin e ndarjes;

c) Drejtuesi teknik i shoqërisë, z. Lula Koçiu, është diplomuar në Bachelor pranë Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, në degën Inxhinieri Mekanike në vitin 2015;

d) Shoqëria UK Memaliaj ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 10 254 banorë të Bashkisë Memaliaj.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Memaliaj, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si: aftësitë tekniko-profesionale, aftësitë financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve, të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar, (ligji nr. 9121), për mos lejin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Memaliaj është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Memaliaj sh.a. me (NUIS M09831502C), në kategoritë:

- a) Kategoria A – Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
- b) Kategoria C – Për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Memaliaj sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

- a) Drejtues ligjor – Petrit Shaha;
- b) Drejtues teknik – Lula Koçiu.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Memaliaj sh.a. është Bashkia Memaliaj.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Memaliaj sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës, brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Memaliaj sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani